

# Reforma zgjedhore si synim apo reforma zgjedhore me synime?!

Yll Buleshkaj

Zgjedhja e sistemit zgjedhor është një nga vendimet më të rëndësishme të institucioneve në kuadër të një demokracie. Arsyeja kryesore e rëndësishme së sistemit zgjedhor qëndron në atë se i përcakton jo vetëm se kush zgjidhet dhe kush përfaqësohet, por edhe kush mund të garojë për t'u zgjedhur. Sistemet zgjedhore rrallëherë janë zgjedhur apo janë reformuar në bazë të nevojave të shoqërisë, ato kryesisht janë trashëguar nga sistemet paraprake. Kjo ka rrjedhur si rezultat sepse në fillimet e ndryshimeve të sistemeve nuk janë zhvilluar analiza të detajuara për qëllimet që duhet arritur me sistemin zgjedhor, ku shpesh shfaqet nevoja e rishikimit të tyre. Riformimi i sistemit zgjedhor në Kosovë nuk përjashtohet nga ky rregull.

Rishikimi i legjislacionit zgjedhor pas çdo dy palë zgjedhjeve për plotësim-ndryshime konsiderohet përgjithësisht si praktikë e mirë. Në Kosovë rishikimi i kornizës ligjore zgjedhore bëhet kryesisht pas ndonjë krize politike ose presioni nga jashtë dhe jo si nevojë e natyrshme për t'i adresuar mësimet e zëna apo synimet e reja të shoqërisë. Si rezultat, akterët e reformës nuk shqyrtojnë ndikimin e reformës tek shoqëria si tërësi e sidomos ndikimin e saj te votuesi.

Se sa shpesh vendoset që të rishikohet legjislacioni zgjedhor ka praktika të ndryshme në Evropën e pas Luftës së Dytë Botërore. Deri më tani, Gjermania ka pasur dhjetë procese të reformës zgjedhore, Belgjika ka pasur tetë procese reforme, ndërsa Italia vetëm disa herë. Pra, këta numra tregojnë që reforma bëhet vetëm sipas nevojave dhe kur ka një konsensus kombëtar për ndryshime dhe gjithmonë për t'u arritur një qëllim i caktuar.

Kosova të paktën dy herë, një herë para e një herë pas shpalljes së pavarësisë, me sukses i është "turru" legjislacionit që përkufizon kornizën e organizimit të zgjedhjeve si bazë edhe e sistemit politik në Kosovë. Në të dy rastet, por edhe gjatë tentativës së tretë, qytetari i vendit nuk duket që ka qenë në qendër të vëmendjes. Roli i qytetarit është thjeshtëzuar në rolin e votuesit, ndërsa reforma më shumë ka pasur parasysh administrimin e sistemit.

Nëse suksesin e reformës e bazojmë me atë se sa është fuqizuar votuesi, atëherë historia e reformave zgjedhore në Kosovë njih dy fitore të mëdha të votuesve: hapjen e listave kandidatëve të subjekteve politike, pra zbatimin e votimit preferencial, si dhe me vendosjen për votim direkt nga votuesit të kryetarëve të komunave. Të dyja këto fitore të votuesve kanë qenë të përkrahura dhe të ndikuar fuqishëm nga organizatat e shoqërisë civile kosovare. Të dyja këto fitore duket që do të mund të pësojnë nga reforma e ardhshme zgjedhore.

Diskursin kosovar për reformë e dominojnë tema si: a është koha e duhur apo jo, shumë zona apo një zonë zgjedhore, lista zgjedhore të hapura apo të mbyllura, kuota gjimore dhe etnike apo pa to, si dhe tema tjera që shkojnë përtej legjislacionit zgjedhor siç janë numri i anëtarëve të Kuvendit të Kosovës apo zgjedhja direkt nga votuesit për presidentin e shtetit. Shumica e studiuave të pavarur pajtohen që për reformë të mirëqenë ka nevojë praktikisht të arrihet konsensus shoqëror dhe politik që të fillohet një e tillë, një konsensus të tillë vështirë të mund të arrihet me këtë nivel mosmarrëveshjes në mes pozitës dhe opozitës kosovare. Ideja e më shumë zonave zgjedhore bëhet me qëllim të lidhjes më të mirë

të votuesve me të zgjedhurit, por kjo mund të shkaktojë edhe fragmentim dhe rajonizim shtesë të shoqërisë kosovare. Derisa lista e mbyllur e kandidatëve të subjekteve politike do të mundësojë administrim dukshëm më të lehtë të numërimit të votave nga KQZ-ja, si dhe një kontroll edhe më të rreptë nga liderët partiakë se kush do të mund të zgjidhet, votuesit kosovarë do t'i merret një e drejtë e madhe e fituar vetëm pak vjet më parë. Për më tepër, nëse synohet zvogëlimi apo rritja e numrit të deputetëve në Kuvendin Zgjedhor, heqja apo ndryshim i kuotave gjimore dhe etnike apo edhe zgjedhjen direkt të presidentit nga votuesit do të duhej paralelisht të realizohet edhe reforma kushtetuese në Kosovë.

Shumica e njohësve të zgjedhjeve pajtohen që Kosova ka nevojë për reformë zgjedhore qoftë për plotësimin e legjislacionit, ashtu edhe për thjeshtëzimin e tij. Pra, ka nevojë për një reformë zgjedhore që paraprihet nga vendime të qarta politike se ku synohet të arrihet me reformë e që këto vendime do të pasoheshin nga analiza të detajuara nga ekspertët për rrugët më të mira për t'u arritur caku i synuar. Po ashtu, shumica e problemeve që hasen me proceset zgjedhore nuk ndërliken direkt me zgjedhjet, por kryesisht me vullnetin politik të subjekteve politike, si dhe me funksionimin e duhur të institucioneve jozgjedhore, sidomos për sa i përket pastrimit të Listës së Votueseve.

Për fund, po, reforma zgjedhore është e nevojshme por mbesin shumë pyetje pa përgjigje. A është tash koha e duhur? A dihet çka synohet me këtë reformë? A mund të arrihet konsensusi shoqëror, aq shumë i nevojshëm? A është bërë ndonjë analizë paraprake? E shumë të tjera...